



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.36/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi-kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më 17.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pa bazuar ankesa e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.36/2025, e datës 15.09.2025, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

A r s y e t i m

Me datën 15.09.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën e identifikuar me numër ZL.Anr.36/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, me te cilën pretendon se më datë 13.09.2025, kandidati i PDK-së për kryetar të Skenderajt, Sami Lushtaku, gjatë paraqitjes televizive në emisionin “Jehona Politike” në Klan Kosova, ka bërë thirrje të hapura për dhunë, i cili ka deklaruar se *“Unë mendoj që qytetarët e këtij vendi duhet me dale në rrugë dhe me dalë në protestë dhe duhet me kërkuar që ata që nuk e respektojnë Kushtetutën, nuk i respektojnë ligjet e Kosovës, nuk e respektojnë Prokurorinë, unë mendoj që ata duhet t'i ngrehim zvarrë nëpër rrugët e Prishtinës”*. Me këto deklarata sipas parashtruesit të ankesës, ka bërë Shkelje të 34 paragrafi 1, pika 1.11 të ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Në përgjigjen në ankesë: Në përgjigje në ankesë pranuesi i ankesës ka deklaruar se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë për arsye se, fillimisht, PDK-ja ka shpërndarë udhëzime të qarta dhe të detajuara për të gjithë anëtarët e saj, duke theksuar rëndësinë e respektimit të ligjit për zgjedhjet e përgjithshme. Kjo është një masë për të siguruar që të gjithë të angazhuarit në aktivitete zgjedhore të përmbahen nga përdorimi i gjuhës fyese dhe kërcënuese, si dhe të ruajnë një nivel të lartë etik dhe profesionalizmi gjatë fushatës. Ky veprim i partisë është një

dëshmi e angazhimit të saj për të siguruar një proces zgjedhor të ndershëm dhe pa incidente. Tutje, në përgjigje në ankesë theksohet se Kryeministri Albin Kurti, ndaj të cilit është bërë deklarata e Sami Lushtakut, nuk është pjesë e garës zgjedhore për zgjedhjet lokale. Ky fakt është thelbësor dhe do të duhej të merrej parasysh në analizën e mundshme të shkeljes. Deklarata e bërë nga z. Lushtaku nuk mund të cilësohet si shkelje e rregullave të zgjedhjeve. Kjo është për arsye se deklarata është drejtuar ndaj një personi që nuk është pjesë e garës dhe, për rrjedhojë, nuk ka ndikim direkt në procesin zgjedhor. Kjo gjithashtu vë theksin mbi faktin se fushata për zgjedhjet lokale është një proces që zhvillohet në nivele të caktuara, ku çdo ndikim nga individë të cilët nuk janë të angazhuar në garë është jashtë kontekstit të rregullave zgjedhore.

Në përgjigje theksohet se deklarata e Sami Lushtakut, duhet të interpretohet si një thirrje për qytetarët që të reagojnë në mënyrë aktive dhe të kërkojnë përgjegjësi nga ata që shkelin ligjin dhe Kushtetutën. Ndërsa mund të ketë një përdorim të fortë të gjuhës, kjo deklaratë nuk mund të interpretohet si një nxitje për dhunë, por si një thirrje për veprime qytetare për të kërkuar respektimin e institucioneve të Kosovës. Tutje, kanë shtuar se është e rëndësishme të theksohet se Lushtaku ka përdorur një shprehje metaforike ("t'i ngrejmë zvarrë") që, edhe pse e fortë dhe e drejtpërdrejtë, nuk mund të interpretohet si një thirrje për dhunë. Ky lloj shprehje mund të ketë një kuptim figurativ, duke sugjeruar që ata që shkelin Kushtetutën dhe ligjin duhet të mbajnë përgjegjësi për veprimet e tyre, por nuk nënkupton ndonjë akt të dhunshëm ose të paligjshëm. Deklarata ka për qëllim të nxisë një reagim qytetar dhe të bazuar në parimet e drejtësisë, dhe jo një veprim të dhunshëm apo të jashtëligjshëm.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), vlerësoi se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: *"Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë"*.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Paneli i vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në intervistën kandidati i PDK-së për kryetar të Skenderajt, Sami Lushtaku në të cilën ka deklaruar se *"Unë mendoj që qytetarët e*

*këtij vendi duhet me dalë në rrugë dhe me dalë në protestë dhe duhet me kërkuar që ata që nuk e respektojnë Kushtetutën, nuk i respektojnë ligjet e Kosovës, nuk e respektojnë Prokurorinë, unë mendoj që ata duhet t'i ngrehim zvarrë nëpër rrugët e Prishtinës", sipas vlerësimit të Panelit, kjo deklaratë nuk i është drejtuar ndonjë personi konkret-individi apo ndonjë subjekti politik, gjegjësisht ankuesit të subjektit politik Vetëvendosje dhe mbi këtë arsye, nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të ndonjë subjekti politik.*

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se është kryer shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se *"Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 par. 3, lidhur me nenin 118 pa. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.36/2025 datë 17.09.2025



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.81/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Rustem Thaqi dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës të Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës ( PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Lokale në Republikën e Kosovës, të paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ZL.A.nr.36/2025 të dt.17.09.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.09.2025 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ZL.A.nr.36/2025 të dt. 17.09.2025.

A r s y e t i m



Me dispozitivin e vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) ZL.A.nr.36/2025 të dt.17.09.2025, është refuzuar si e pabazuar ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZLA.nr.36/2025 dt.15.09.2025, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës.

Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP, Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me kohë ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, nëpërmjet të cilës konteston ligjshmërinë e vendimeve të sipër cekura, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohet vendimi i sipër përmendur i PZAP-së, të urdhërojë PZAP-në, që ti shqiptojë masat sanksionuese ndaj kandidatit Sami Lushtaku dhe Subjektit Politik PDK, si në ankesë, e cila gjendet në shkresat e lëndës.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, përmes të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje, është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 15.09.2025 ka pranuar ankesën nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendon se më dt.13.09.2025, kandidati i PDK-së për Kryetar të Skenderajt, Sami Lushtaku, gjatë paraqitjes televizive në emisionin “Jehona Politike” në Klan Kosova, ka bërë thirrje të hapura për dhunë, i cili ka deklaruar se “Unë mendoj që qytetarët e këtij vendi duhet me dalë në rrugë dhe me dalë në protestë, dhe duhet me kërkuar që ata që nuk e respektojnë Kushtetutën, nuk i respektojnë ligjet e Kosovës, nuk respektojnë Prokurorinë, unë mendoj që ata duhet t’i ngrehim zvarrë nëpër rrugët e Prishtinës”, me këto deklarata sipas parashtruesit të ankesës, janë bërë shkelje të nenit 34 par.1, pika 1.11 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme.



Në përgjigjen në ankesë, pranuesi i ankesës ka deklaruar se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë për arsye se, fillimisht, PDK ka shpërndarë udhëzime të qarta dhe të detajuara për të gjithë anëtarët e saj, duke theksuar rëndësinë e respektimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo është një masë për të siguruar që të gjithë të angazhuarit në aktivitete zgjedhore të përmbahen nga përdorimi i gjuhës fyese dhe kërcënuese, si dhe të ruajnë një nivel të lartë etik dhe profesionalizmi gjatë fushatës. Ky veprim i Partisë është një dëshmi e angazhimit të saj për të siguruar një proces zgjedhor të ndershëm dhe pa incidente dhe se deklarata e tij, duhet të interpretohet si një thirrje për qytetarët që të reagojnë në mënyrë aktive dhe të kërkojnë përgjegjësi nga ata që shkelin Ligjin dhe Kushtetutën, dhe se kjo deklaratë nuk mund të interpretohet si një nxitje për dhunë, por si një thirrje për veprime qytetare për të kërkuar respektimin e institucioneve të Kosovës, si dhe e njëjta ka për qëllim të nxisë një reagim qytetar dhe të bazuar në parimet e drejtësisë, dhe jo në një veprim të dhunshëm apo të jashtë ligjshëm.

Në arsyetimin e vendimit të tij, PZAP-i, theksoi se pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, vlerësoi se pretendimet e Subjektit Politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi si të pa bazuara, për faktin sepse veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 par.1 nënp.1.11 të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, në formë të shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxit urrejtje kundër tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Paneli i vlerësoi se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që në intervistën kandidati i PDK-së për Kryetar të Skenderajt, Sami Lushtaku në të cilën ka deklaruar, siç u sipër citua më lartë, sipas vlerësimit të Panelit, kjo deklaratë nuk i është drejtuar ndonjë personi konkret – individ apo ndonjë subjekti politik, gjegjësisht ankuesit të subjektit politik Vetëvendosje dhe mbi këtë arsye, nuk ka gjetur se janë shkelur rregullat zgjedhore në dëm të një subjekti politik.



Ndaj, nga arsyet e sipër cekura, PZAP-i, ka konstatuar se pretendimet për shkeljet e sipër përmendura, për të cilat nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoi, për faktin sepse, nga veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës, nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartë cekura, dhe të njëjtën, në kuptim të nenit 117 par.3 të LZP-së, e refuzoi si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me shkeljet e pretenduara të Subjektit Politik LVV, të përshkruara më sipër, me që vendimi i të njëjtit organ nuk është i kundërligjshëm, është i bazuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, në dispozitat e sipër cituara ligjore. Vendimi i PZAP-së, është marrë pasi që më parë, në mënyrë të sigurt është vërtetuar se në rastin konkret juridik nga ana e kandidatit dhe Subjektit Politik PDK-së, nuk ka shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, ndaj, në kuptim të dispozitës së nenit 117 par.3, etj, të LZP-së, ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të sipër përmendur.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtruesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, përkatësisht, shkeljet e dispozitave përkatëse të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, etj, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe nga arsyet e dhëna më lartë, PZAP, përkitazi me këtë rast, ka vlerësuar të gjitha provat e administruara dhe shkresat e lëndës, nga të cilat ka rezultuar se në rastin konkret nuk qëndrojnë shkeljet e pretenduara nga Subjekti Politik LVV.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e PZAP-it, i cili, për arsyet e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën e paraqitur nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, kundër vendimit të kontestuar, e refuzoi si të pa themeltë.



Nga arsyet e sipër përmendura, e në pajtim me dispozitat e nenit 118 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

ZL.A.m.81/2025 dt. 22.09.2025


Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha



Republika e Kosovës  Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON  
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

  
Punëtori i autorizuar  
Oraščeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës: AA-89/2025  
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNIKA ZA-LICNO DOSTAVLANJE

PZAP PRISTINA

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca ( pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më \_\_\_\_\_ 201 \_\_\_\_\_ në ora \_\_\_\_\_  
dana \_\_\_\_\_ u \_\_\_\_\_ cas.  
Shkaku i refuzimit të marrjes \_\_\_\_\_  
Razlog odbijanja prijmea \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljacka

Emri i shkresës që dorëzohet:  
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTG-JUKIM  
22.09.2025

Numri i shtojcave: \_\_\_\_\_  
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur  
më (me fjalë)  
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma  
( i slovima )

Atushi 22.09.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që  
e ka marrë aktin në vend të tij  
Potpis primaoca ili lica koje je  
pismeno primilo u zamenu) 09 14:25

\_\_\_\_\_  
Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljacka

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ato je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpise, potpisuje ga dostavljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.